



Vendim: Nr. 01/08/16.007

Data: 01.08.2016

Në pajtim me Politikën e vleresimit, testimit dhe ri-testimit CE 20160801.006, Cactus Education merr këtë:

POLITIKA PËR RI-PROVIME

1. Organizimi i një ri-provimi pas përfundimit të semestrit nuk është rregull por është përjashtim dhe mund të bëhet vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të arsyetueshme.
2. Një ri-provim, teorik dhe praktik, e i cili mund të përfshijë tërë materien e lëndës, mund të organizohet në raste të arsyetueshme dhe të jashtëzakonshme, me kërkesë të studentit, kur shkolla e shihet të arsyeshme, dhe vetëm kur mësimdhënësi, respektivisht materia e lëndës për të cilën kërkohet të organizohet ri-provimi e lejon organizimin e atij ri-provimi në atë formë.
3. Vendimin për organizimin e ri-provimit e merr Këshilli i departamentit ose Drejtori/Dekani pas rekomandimit të mësimdhënësit të lëndës.
4. Ri-provimi nuk mund të organizohet deri sa zgjatë semestri i rregullt kur ofrohet lënda. Ri-provimi mund të organizohet në kohën në mes të dy semestrave, por përpara fillimit të semestrit të rregullt të ardhshëm kur ofrohet ajo lëndë.
5. Organizimi i një ri-provimi pas përfundimit të semestrit kërkon kohë dhe angazhim, dhe shkakton shpenzime shtesë të cilat shkolla i ndanë me studentët që duan të hyjnë në ri-provim. Tarifa për studentin për të hyrë në një ri-provim, është **5.00 EUR** për çdo kredi ECVET të lëndës për të cilën organizohet ri-provimi. Tarifa paguhet paraprakisht dhe është e pakthyeshme pavarësisht rezultatit të vlerësimit.

Kjo politikë hyn në fuqi menjëherë dhe mbetet në fuqi deri në sjelljen e një vendimi për ndryshimin e saj.

Drejtori i shkollës

Kastriot Fazliu